



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT BERND BORCHARDT, NË NJË TAKIM ME STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

6 shkurt 2017

Rruga drejt progresit dhe një të ardhmeje më të mirë është e vështirë, por ia vlen.

OSBE-ja është e përkushtuar ta ndihmojë Shqipërinë në arritjen e standardeve më të larta demokratike me qëllim përmbushjen e Angazhimeve të saj në kuadër të OSBE-së. Demokracia, Shteti i së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut janë shtyllat kryesore të shoqërive moderne dhe funksionale. Në fakt, qeverisja funksionale në Shqipëri pengohet ende nga mungesa e dialogut në nivelet më të larta politike, politizimi i administratës publike, administrimi i ngadaltë i zgjedhjeve, korrupsioni gjerësisht i përhapur dhe krimi i organizuar. Këto probleme nuk mund të zgjidhen për një ditë apo për një vit, por me angazhimin e secilit, jam i sigurt se Shqipëria do t'ia dalë.

Unë kam ardhur në Shqipëri për herë të parë në vitin 1996, kur shumica nga ju ishit ende fëmijë; gjeta një vend jashtëzakonisht të varfër, të çorganizuar, pjesërisht anarkik, vende-vende të kontrolluar nga dhuna dhe me një demokraci të njomë me shumë probleme. U ulëm në një aeroport të ndërtuar që para lufte, udhëtuam me makinë nëpër rrugët me gropa, mes bunkerëve dhe lopëve, drejt një qyteti të mbushur me baraka dhe me pak dritë.

Sot, Shqipëria ka ecur përpara aq sa nuk ma priste mendja në 1996-n, por i mbetet ende rrugë e gjatë për të bërë. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e përqendron mbështetjen e saj në një sërë fushash, ku besojmë se mund të sjellim ndryshim dhe ku vendit nuk po i ofrohet ndonjë mbështetje tjetër. Dhe “për garniturë”, po ju jap disa shembuj në lidhje aktivitetet tona.

Kryesia e Radhës e OSBE-së këtë vit e ka përcaktuar Rininë si një nga prioritetet e saj kryesore. Të rinjtë si ju janë ata që mbajnë në duar çelësin e

drejtimit që do të marrë Shqipëria. Pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike dhe në mediat sociale, parandalimi i radikalizimit të të rinjve dhe bashkëpunimi rajonal i të rinjve janë veçse disa nga prioritetet tona.

Me orientimin e Kryesisë Austriake, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është fokusuar më shumë te rinia këtë vit, dhe ka përgatitur së fundmi një projekt të ri në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Ambasadën Austriake: Rruga e Rinisë, siç e quajmë. Ky projekt do të organizojë diskutime mbi rininë, radikalizimin, paqen dhe sigurinë, i ndërthurur me veprimtari në natyrë. Pjesëmarrësit do të vijnë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ne punojmë edhe me të rinjtë në fshatra e qyteza në mbarë vendin. Këto aktivitete janë një mundësi unike për të sjellë bashkë të rinjtë, vendimmarrësit dhe figurat publike, që të diskutojnë mbi demokracinë dhe të planifikojnë nismat vendore.

Në fund, do të përpiqemi të krijojmë një Grup Këshillimi Rinor për veten tonë, që t'i shërbejmë më mirë të rinjve shqiptarë përmes punës sonë me bazë programesh.

Ka edhe sfida të tjera. Zgjedhjet po afrojnë; ato janë hapi i parë drejt një të ardhmeje më të mirë. Ju do të bëni zgjedhjen tuaj. Mund të tundoheni të mos votoni, të shisni votën, apo ta fotografoni, që të vërtetoni se keni votuar për njerëzit "e duhur". Ju e zgjidhni vetë demokracinë ku doni të jetoni, prandaj, ju lutem, bëni zgjedhjen e duhur. Ne e mbështesim Shqipërinë me reformën e ligjit zgjedhor, japim këshilla për praktikën më të mira. Kolegët tanë nga OSBE/ODIHR-i do të vijnë për të monitoruar zgjedhjet – ju takon juve shqiptarëve të vendosni në cilën mënyrë doni të votoni.

Të drejtat e njeriut në Shqipëri përgjithësisht respektohen, por ende nevojiten përpjekje në fusha si mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, dhuna me bazë gjinore, si dhe kthimi dhe kompensimi i pronës. Tashmë prej shumë vitesh jemi përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – që shpesh përbën dhunime shumë të rënda të të drejtave të njeriut. Ne punojmë me burgjet dhe shërbimin e provës që të përmirësojmë këtë sektor të sistemit gjyqësor shqiptar.

Shqipëria ka kaluar ndryshime rrënjësore këto 25 vitet e fundit, ku një ndër ndryshimet më të rrezikshme ka qenë përhapja e mëtejshme e kanabisit në vend. Kanabisi dëmton shoqërinë dhe brezat e ardhshëm. Ne duhet të bëjmë

zgjedhjet e duhura, por sidomos rinia: A punoj në plantacione të paligjshme? A e përdor kanabisin? A e shes?

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do ta mbështesë qeverinë në përpjekjet e saj për zbatimin e një plani tërësor në luftën kundër kanabisit.

Një tjetër aktivitet i Prezencës së OSBE-së, i zhvilluar pikërisht në këtë sallë, ka të bëjë me të përballjen me të kaluarën. Për brezin e ri që i ka sytë nga e ardhmja, përballja me të kaluarën mund të duhet si humbje kohe, por jam plotësisht i bindur që jo. Të garantosh mospërsëritjen e gabimeve do të thotë të garantosh një të ardhme më të mirë. Unë jam nga Gjermania, një vend që, shekullin e fundit, i është dashur të përballlet dy herë me të kaluarën: pas diktaturës naziste dhe Luftës II Botërore, si edhe pas diktaturës komuniste. Jam aq në moshë për të parë qasje të ndryshme për të kaluarën në vendin tim: shumë vite heshtje e thellë pas Luftës II Botërore, por që çuan në aktivizëm qytetar të shoqërisë në përballje me të kaluarën. Për vendin tim ky ka qenë një proces çlirues - me gjithë mangësitë e procesit – për të zhvilluar një narrativë të re për të kaluarën. Kemi përshtypjen se në Shqipëri, shumë kanë nevojën që të diskutojnë për atë çfarë ka ndodhur nga viti 1944 deri në 1990-ën. Ne presim me padurim ta mbështesim këtë proces, bazuar në përvojën e shumicës së Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Lufta kundër korrupsionit; ndihma për shkatërrimin e frenezisë së armatimeve të rrezikshme të mbetura nga koha e Hoxhës, përmirësimi i lidhjeve ndërmjet qytetarit dhe parlamentit; këto dhe një sërë projektesh të tjera janë në zbatim.

Por, më është kërkuar të flas edhe mbi sfidat bashkëkohore për kulturën.

Besoj se Shqipëria në këtë fushë përballlet me të njëjtat sfida si vendet e tjera. Ku jemi në lidhje me sfidat bashkëkohore ndaj artit dhe kulturës, në Shqipëri dhe në Evropë?

Bota po kalon ndryshime të mëdha: shikoni refugjatët dhe vuajtjet e tyre, emigrimin masiv, kërcënimet terroriste kudo, kërcënimet e perceptuara apo reale ndaj mirëqenies ekonomike në vendet e zhvilluara të BE-së, disbalancat në shpërndarjen e pasurisë, edhe shumë të tjera.

Si pasqyrohen këto në art? Jam plotësisht i vetëdijshëm se arti ka nevojë për kohë që të pasqyrojë ndryshimet si këto që përmenda. Arti duhet të depërtojë, të ketë thellësi.

Mund të duhet kohë e gjatë derisa arti të pasqyrojë siç duhet ndryshimet madhore, derisa këto ndryshime të gjejnë vendin e tyre në art. Lufta I dhe II Botërore, ndryshime i paradigmës në 1989-1990 pati nevojë për kohë që të depërtojë në art, që arti ta pasqyronte në shkallë më të gjerë.

Që nga 11 shtatori, përballemi me kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në shkallë globale si edhe në Shqipëri.

Që nga viti 1990, Shqipëria dhe shumë shtete të tjera, si dhe artistët në këto vende, janë sfiduar nga ndryshimi i paradigmës që erdhi me fundin e diktaturës komuniste dhe përbalimin e kësaj të kaluarë.

Politika po përballet me të kaluarën, ndonjëherë në mënyrë tërësisht të diskutueshme, por arti po e bën të njëjtën gjë? Arti duhet të jetë një nga instrumentet për t'i ndarë zhvillimet politike dhe sociale edhe në këtë kontekst, si një mënyrë për të depërtuar brenda botës.

Ne duam ta inkurajojmë këtë gjë. OSBE-ja mbështet në Shqipëri dialogun kombëtar për Përbaljen me të Kaluarën, nismë kjo që përfshin shfaqje teatrale, si këtu tek *Black Box*, shfaqje filmash dhe diskutime. Gjithashtu, ne jemi gati që të mbështesim punën për tekstet shkollore dhe planprogramet mësimore. Por ne shpresojmë gjithashtu që artistët shqiptarë ta pasqyrojnë këtë temë më shumë në punën e tyre, si edhe temën e radikalizimit fetar që çon në dhunë.

Jam mëse i vetëdijshëm që kjo është sfidë dhe përmban rrisqe. *Walter Benjamin* njëherë shkroi për riskun e përfshirjes së artit në politikë. Ai përmendi estetizimin e politikës në fashizëm dhe politizimin e estetikës në komunizëm.

Që nga ajo kohë janë shtuar risqet për artin: risku i vëllazërimit me paranë në vend të tematizimit të zhvillimeve; zëvendësimi i lojës së artit me tregjet me aferat e artistëve me tregjet – ku e këndshmja dhe e pëlqyeshmja ia dalin disi të fitojnë terren.

Por nuk janë vetëm këto. Mund të përmend dy: riskun e korrektesës politike, ndërkohë që arti duhet të ofrojë ose mund të ofrojë draftin alternativ. Ose thjesht politizimin, ku etiketimi politik zëvendëson çështjen e relevancës së artit për pozicionimin e artit midis traditës dhe diskursit aktual. Për ta përmbledhur: risku që një qasje e rëndomtë të zëvendësojë thellësinë dhe estetikën.

Një shembull i kohëve të fundit, shumë i debatuar në vendin tim, ishte vënia në skenë gjatë vitit të kaluar e *Parsifal në Bayreuth*, i vendosur në një mjedis artificial refugjatësh irakianë, një ofendim i rëndomtë për një kompozitor, kompozimet komplekse të të cilit as që kanë nevojë për aktualizim artificial.

Duke parë sfidat madhore me të cilat përballet Evropa dhe vendi juaj gjithashtu, ne duam të inkurajojmë artistët e rinj që të punojnë për disa prej këtyre sfidave pa rënë në grackat me të cilat përballet arti. Ne ju inkurajojmë që të punoni me dy temat dhe sfidat që përmenda: Shqipëria që përballet me të kaluarën komuniste dhe Shqipëria që i kundërvihet ekstremizmit të dhunshëm.

Ne, së bashku me Universitetin e Arteve dhe Fakultetin e Arteve të Bukura, mbështesim një konkurs të artistëve për këto tema – punimet më të mira do të përzgjidhen nga një panel ekspertësh dhe 2 fituesit do të fitojnë secili çmimin prej 500 eurosh. Të gjithë punimet më të mira – pikturat, instalacionet, apo skulpturat – do të jenë pjesë e një ekspozite te Galeria FAB për publikun vendas dhe ndërkombëtar në Shqipëri.

Shpresoj që të mund t'ju motivoj që të merrni pjesë. Iu uroj fat të gjithë pjesëmarrësve në këtë konkurs. Iu jam mirënjohës lektorëve dhe profesorëve për mbështetjen që i japin këtij konkursi dhe sigurisht që jam shumë kureshtar për rezultatin.